



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Ac.nr.7333/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Dr.sc. Rafet Haxhaj, kryetar dhe Hunaida Pasuli e Frosina Sylejmani anëtarë, me zyrtaren ligjore Fitore Isufi-Saraçi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses R. G nga Prizreni, të cilën e përfaqëson B. K avokat në Prizren, kundër të paditurës Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur, për kompensimin e shujtave ditore, duke vendosur sipas ankesës të palës së paditur, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.1072/2023 të datës 27.09.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 05.04.2024, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar, ankesa e të paditurës Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.1072/2023 i datës 27.09.2023, VËRTETOHET.

### A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, në pikën I, të dispozitivit aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses R. G nga Prizreni. Në pikën II., të dispozitivit detyrohet e paditura, Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur (AAPARr) në Prishtinë, që paditëses R. G, t'ia paguajë kompensimin e ushqimit gjatë ditëve të pranisë në punë për vitin 2022 nga data 01.01.2022 e deri me datën 21.11.2022 dhe atë për 179 ditë të pranisë në punë nga 2 (dy) € për një ditë pune, gjithsej vlerën e përgjithshme prej 358.00 € dhe atë me kamatë ligjore prej 8 % në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga dita e paraqitjes së padisë (07.04.2023) deri në pagesën definitive, në afat prej 7 (shtatë) ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të ekzekutimit të detyrueshëm. Në pikën III., të dispozitivit detyrohet e paditura që paditëses t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore shumë prej 125 €, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

Kundër këtij aktgjykimi, ka parashtruar ankesë e paditura, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, të prishet aktgjykimi i atakuar dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësja R. G ka parashtruar padi ndaj të paditurës Agjencia e Arsimit dhe Aftësimin Profesional dhe Arsimit për të Rritur në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditëses t'ia paguajë kompensimin e ushqimit gjatë ditëve të pranisë në punë për vitin 2022 nga data 01.01.2022 e deri me datën 21.11.2022 dhe atë për 179 ditë të pranisë në punë nga 2 (dy) € për një ditë pune, gjithsej vlerën e përgjithshme prej 358.00 € dhe atë me kamatë ligjore prej 8 % në nivel vjetor.

Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar gjendjen faktike se: R. G është në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënës në ..., në Prizren. Paditësja, në vitin 2022 deri më 21.11.2022 ka prezantuar në punë gjithsej 179 ditë pune. Gjykata e shkallës së parë ka gjetur që e paditura nuk e ka përmbushur detyrimin ndaj paditësit, detyrim ky që rrjedhë nga Kontrata Kolektive.

Gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimin të atakuar me ankesë.

### **Baza ligjore:**

Neni 194 i LPK-së: "Gjykata e ankimit ekzaminon aktgjykimin e shkallës së parë në atë pjesë në të cilën është goditur me ankesë dhe atë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi, pika b), g), j), k), dhe m) të këtij ligji".

Neni 195.1 i LPK-së: "Gjykata e ankimit mundet, në seancën e kolegjit apo në bazë të shqyrtimit të çështjes të bërë drejtpërdrejt para saj: .....d) ta refuzojë ankesën si të pa themeltë dhe ta vërtetojë aktgjykimin e goditur".

### **Vlerësimi i Gjykatës së Apelit:**

Kolegji i gjykatës së shkallës së dytë vlerëson se, aktgjykimi i atakuar me ankesë nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore. Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit në tërësi të kërkesëpadisë së paditësit, duke e detyruar të paditurën që paditësit t'ia paguaj në emër të shpenzimeve të ushqimit me të drejtë është bazuar në nenin 35.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e lidhur me datë 22.01.2021, të nënshkruar nga Sindikata e bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës dhe MASHT nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Në këtë kontratë në Nenin 35, paragrafi 7, është përcaktuar që: *“Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”.*

Kolegji vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore që gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike. Gjykata e shkallës së parë mbi bazën e dokumentacionit shkresor të ofruar nga pala paditëse e që janë dokumente zyrtare të të paditurës ka vërtetuar numrin e ditëve të punës për paditësin.

Kolegji ka vlerësuar që nuk qëndrojnë pretendimet e palës së paditur që gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të gabuar e ka aplikuar të drejtën materiale për arsye se me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve. Me paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) në nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës. Me paragrafin 4 përcaktohet se Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”.* Nga kjo, kolegji i gjykatës së shkallës së dytë vlerëson se, vendimi i gjykatës së shkallës së parë është në pajtueshmëri të plotë me nenin 35.7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e lidhur me datë 22.01.2021 dhe nenin 90 Ligjit të Punës, nga rrjedh themelësia e kërkesëpadisë. Kolegji pretendimet e të paditurës sa i përket vlefshmërisë së Kontratës Kolektive të Arsimit, i ka refuzuar si të pa bazuar pasi që në rastin konkret kërkesa e paditësit gjen mbështetje në Kontratën Kolektive

të Arsimit të datës 22.01.2021. Për këto arsye edhe pretendimet ankimore të palës së paditur i ka refuzuar si të pa bazuara, ndërsa e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Kolegji gjen gjithashtu se, në nenin 322.3 të LPK-së është përcaktuar se: *“Pala e cila e konteston ekzistimin e ndonjë të drejte e bartë barrën e të provuarit të faktit që e ka penguar krijimin apo realizimin e saj, ose në bazë të të cilit ka pushuar se ekzistuari, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër”*. E paditura përveç kontestimit verbal, nuk ka ofruar ndonjë provë që do të provonte një gjendje tjetër nga sa është vendosur si në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë. Në nenin 319.1 i LPK-së përcakton se: *“Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provoj faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”*. Sipas vlerësimit të kolegjit, pala e paditur nuk ka arritur që të bëjë një gjë të tillë andaj edhe pretendimet ankimore janë refuzuar si të pa bazuara.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.7333/2023 me datë 05.04.2024

Kryetari i kolegjit - gjykatësi,  
Dr.sc. Rafet Haxhaj